



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. ____ prot.

Tiranë më, ____ . __. 2023

URDHËR

Nr. ____ datë, ____ .04. 2023

PËR

CAKTIMIN E PERSONELIT NË ZBATIM TË UDHËZIMIT TË PËRGJITHSHËM
NR.3/2019, I NDRYSHUAR PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES
VENDORE 2023¹

Në mbështetje, të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutes, neneve 38 pika 2 shkronja “k”, 107/1 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 167/1 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligji nr.10019/2008, i shtuar me ligjin nr. 101/2020, dekretit 13864 datë 24.10.2022 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” dhe pikës 1 të nenit 5 e vijues të udhëzimit të përgjithshëm nr.3/2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, i ndryshuar me udhëzimin e përgjithshëm nr.2/2021;

URDHËROJ:

1. Për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.3/2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, i ndryshuar dhe qarkores nr.457/1, datë 03.04.2023 “Për masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023”, pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional² në Prokurorinë e Përgjithshme, caktohen:

- Znj. Alma Muça, prokurore në Drejtorinë e Koordinimit Institucional.
- Z. Albert Muço, oficer i policisë gjyqësore pranë Drejtorisë e Koordinimit Institucional.

¹ Dekretin nr.13864, datë 24 tetor 2022 i Presidentit të Republikës , ku është dekretur caktimi i datës 14 maj 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

² Struktura e posaçme në kuptim e zbatim të pikës 1 të nenit 5 të udhëzimit të përgjithshëm nr.3/2019, i ndryshuar me udhëzimin e përgjithshëm nr.2/2021 është Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Znj. Jonida Zenelaga, specialiste në zyrën e statistikës të Sektorit të Koordinimit, Studimeve dhe Integritit pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional.

2. Personat e caktuar me këtë urdhër, kryejnë detyrat funksionale të tyre, krahas detyrave të normuara me këtë urdhër dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr.3/2019, i ndryshuar.

3. Me këtë urdhër të njihen personat e caktuar dhe drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe personat e tjerë të ngarkuar me zbatimin e udhëzimit e përgjithshëm nr.3/2019, i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 14 prill 2023 deri ditën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA